



**Kompania Regjionale e Mbeturinave
"EKOREGJIONI" Sh.a- Prizren**

RAPORTI FINANCIAR JANAR-MARS 2026 -

Mars 2026

Permbajtja	
Permbledhje ekzekutive -----	2
Hyrje -----	3
Klientet dhe kategorite e tyre -----	4
Faturimi-inkasimi-----	5
Shpenzimet -----	8

Përmbledhje ekzekutive

Raporti financiar për periudhën kohore janar-mars të vitit 2026 paraqet një përmbledhje për të gjitha aktivitetet financiare të zhvilluara gjatë këtij tremujori.

Në raportin financiar do të prezantohen në mënyrë të detajuar përmes tabelave dhe grafikoneve si dhe shpjegimeve tekstuale: kategoritë e klienteve, numri i klientëve të shërbyer dhe krahasimet me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Raporti përmban të dhënat e planifikimit, faturimit dhe realizimin e tyre për periudhën raportuese. Në këtë raport janë të paraqitura të hyrat dhe shpenzimet për këtë tremujor.

Raporti financiar janar-mars 2026 paraqet në mënyrë të detajuar të dhënat për numrin e klienteve sipas kategorive të shërbimeve, planifikimin e faturimit, realizimin e faturimit, përqindjën e realizimit.

Raporti financiar janar-mars paraqet në formë tabelare të dhënat e njësisë Suhareke për planifikim e shpenzimeve, shpenzimet e realizuara, dallimin me shpenzimet e planifikuara. Njëra nga aktivitetet më të rëndësishme të ndërmarrjes që tregon për rrjedhën e parasë prezantohet në mënyrë të detajuar dhe na tregon se ndërmarrja a gjeneron fitim për këtë periudhë,

Raporti financiar përmes grafikoneve të ndryshëm dhe shpjegimeve të tyre paraqet të gjitha të dhënat financiare të kompanisë për këtë tremujor duke na bërë më të qartë pasqyrën e kompanisë për këtë periudhë raportuese.

Hyrje

Bazuar në nenin 2 të Ligjit me Nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-60 për Mbeturina, në nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr.05/L-009 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në Statusin të KRM “Ekoregjioni” Sh.A. dhe Rregullorën Punës së Kompanisë me numer të protokollit e 01-07/395, lidhur me hartimin e raporteve të punës dhe rezultatet e arritura gjatë periudhave të caktuara kohore, në vazhdim po e paraqesim raportin e financiar për periudhën kohore janar-mars 2026.

Në vazhdim të raportit do të prezantohen në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat relevante të cilat janë të rëndësishme për të krijuar një pasqyrë të qartë për njesinë e Suharekes gjatë muajve janar-mars 2026. Ky raport pasqyron performancën financiare të ndërmarrjes gjatë periudhës janar-mars 2026 dhe është përgatitur për të informuar, aksioneret, Ky raport është përgatitur për të pasqyruar performancën financiare të njësisë së Suharekës gjatë periudhës janar-mars 2026, ai përmban një analizë të hollësishme hyrave dhe shpenzimeve dhe flukseve të parasë.

Të ardhurat kryesore janë nga shërbimet siq janë: grumbullimi dhe transporti i mbeturinave, tendencat kryesore financiare janë: inkasimi i borxheve të klienteve, qendrushmëria financiare, pagesa e borxheve ndaj ATK-së dhe furnitoreve.

Raporti është përgatitur për të siguruar: qartësi, qëndrueshmëri dhe krahasueshmëri duke përdorur metodologjinë financiare për krahasimin e rezultateve aktuale me ato të planifikuara, në këtë raport janë paraqitur të dhënat e sakta të cilat janë gjeneruar nga programi Rikont dhe siguron transparencë dhe llogaridhënje ndaj aksionereve, menaxhmentit të ndërmarrjes dhe paleve të tjera të interesit.

Njësia Operative Suharekë

Kategoritë e klientëve në Suharekë:

Kategorit e shërbimeve	Janar-mars 2026
Amvisri-rezident	8,959
Amviseri-jo rezident	5,419
Bizneset	1,072
Institucionet	64
Totali:	15,514

Tab.1. Kategorit e klientëve

Nga tabela shohim në njësinë Suharekë gjatë kësaj periudhe janë 15,556 klientë.




Fig.1. Kategorite e klienteve

Faturimi-inkasimi janar-mars 2026

Faturimi-inkasimi		
Shërbimet publike komunale	Faturimi janar-mars 2026	Inkasimi 100% e faturimit
Amviseria rezident	120,933.00 €	120,933.00 €
Amviseri jorezident	16,257.00 €	16,257.00 €
Lokalet /institucionet	39,652.25 €	39,652.25 €
Totali	176,842.25 €	176,842.25

Tab.2. Faturim- inkasim janar-mars 2026

Nga të dhënat ne tabelën nr.2 faturimi për këtë periudhë është 176,842.25 ndersa inkasimi është llogaritur 100% e faturimit .




Fig 2. Faturimi dhe inkasimi

Shpenzimet tre mujore për njësinë Suharekë

SHPENZIMET E NJESISE SUHAREKE	
01.01.2026-31.03.2026	Shuma
SHPENZIMET E FURNIZIMIT TË ZYRËS	165.92 €
SHPENZIMET E PROVIZIONIT BANKAR	250.94 €
SHPENZIMET E KARBURANTEVE	24,818.25 €
SHPENZIMET E LICENCAVE PER SOFTVER	1,668.60 €
SHPENZIMET ANTARSIMI	202.49 €
SHPENZIMET E INTERNETIT	68.25 €
SHPENZIMET E PREMIS SE SIGURIMEVE	2,326.96 €
SHPENZIMET E REGJISTRIMIT TË AUTO	1,882.10 €
SHPENZIMET E KONTROLLIMIT TEKNIK	236.00 €
SHPENZIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE	3,852.82 €
SHPENZIMET E VAJRAVE	2,572.94 €
SHPENZIMET E DHURATAVE	35.40 €
SHPENZIMET E AUTOGOMAVE	2,700.01 €
SHPENZIMET E MATERIALIT ADMINISTRATIV	507.99 €
SHPENZIMET E PAGAVE	77,735.52 €
SHPENZIMET E KONTRIBUTEVE PENSIONALE	4,325.38 €
SHPENZIMET E KONTRIBUTEVE PENSIONALE PUNEDHENESI	4,325.38 €
SHPENZIMET E TATIMIT NË PAGË	4,446.75 €
SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES , Servisimit,Riparimeve,	34,062.95 €
SHPENZIMET E SHERBIMEVE	99.12 €
SHPENZIMET E TELEFONIT	211.08 €
SHPENZIMET PER GPS	582.13 €
SHPENZIMET E DEPONISE	45,666.16 €
SHPENZIMET E UJIT	178.96 €
PAGESA E TATIMEVE	17,731.77 €
Totali	230,653.88 €

Tab.3. Shpenzimet TM1 2026

Nga tab. vërehet se në TM1 2026 kishte shpenzimet në vlerë prej 230,653.88 €

Përmbledhja e shpenzimeve – Njësia Suharekë

Njesia Suharek	
Te hyrat	176,842.25 €
Furnitoret	107,167.43 €
Pagat	111,936.45 €
Tatimet	11,550.00 €
Totali pagesat	230,653.88 €
Raporti te hyra-shpenzime	-53,811.63 €

Tab.4. përmbledhja e shpenzimeve

Gjatë periudhës janar-mars 2026 inkasimi për njësinë e Suharekës është 176,842.25 € , ndërsa totali i shpenzimeve është (230,653.88) € .

Nese shkojme me kete ritem te shpenzimeve ne fund te vitit 2026 njesia Suhareke do te kete - 215,246.52 euro humbje.

Nga të dhënat e mesiperme në njësinë e Suharekës kemi bilanc negativ për -53,811.63 euro e parase (janar-mars 2026). Pagesat e njesisë Suharekë janë paguar nga njësitë tjera pasi që ka mungesë të mjeteve financiare në këtë njësi. Gjate kesaj periudhe jane paguar dhe borxhet e vitit paraprak te njesise Suharekë me mjete të njesive tjera.

KRM Ekortegjioni Sh.a ka marveshje për pagesën e obligimeve me ATK ne vlerë prej: 264,493.97 euro deri në përfundim të marveshjes

Planifikimi i Faturimi per vitin 2026 per njesine Suhareke

Tarifa 4.5					
Shërbimet publike komunale	Nr klienteve	Faturimi mujor	Inkasimi mujor	Faturimi vjetor	Inkasimi vjetor 95 %
Amviseria rezident	8958	40,311.00 €	40,311.00 €	483,732.00 €	483,732.00 €
Amviseri jorezident	5419	5,419.00 €	5,419.00 €	65,028.00 €	65,028.00 €
Institucionet/bizneset	1136	13,217.42 €	13,217.42 €	158,609.00 €	158,609.00 €
Total	15513	58,947.42 €	58,947.42	707,369.00 €	707,369.00 €

Borgji njesia Suharek	3 dhe 12 muaj	-53,811.63 €	-215,246.53 €
-----------------------	---------------	---------------------	----------------------

Tab.5. Planifikimi me tarife 4.5 euro

Me tariten aktuale ne jemi duke punuar me humbje rreth -53,811.63 euro per kete tre mujor

Planifikimi me rritje te tarifes ne 7 euro

Tarifa 7					
Shërbimet publike komunale	Nr klienteve	Faturimi mujor	Inkasimi mujor 95 %	Faturimi vjetor	Inkasimi vjetor 95%
Amviseria rezident	8958	62,706.00 €	59,570.70 €	752,472.00 €	677,224.80 €
Amviseri jorezident	5419	16,257.00 €	15,444.15 €	195,084.00 €	175,575.60 €
Institucione/biznese	1136	13,217.42 €	10,573.93 €	158,609.00 €	126,887.20 €
Total	15513		85,588.78 €		979,687.60 €

Me rritje tarifes 7 euro	1 dhe 12 muaj	8,704.16 €	104,449.87 €
--------------------------	---------------	-------------------	---------------------

Tab.6. Planifikimi me rritje tarifes 7 euro

Planifikimi me rritje tarifash ne 7 euro ne do te kemi nje gjendje financiare prej 8,704.16 euro te hyra me shume se shpenzimet. Ketu duhet te kemi parasysh se ne vitin 2027 tarifa e mbeturinave ne KMDK do te kete ngritje per 1 euro ne ton dhe nuk eshte e perfshire te tarifa 7 euro

Planifikimi me rritje tarifes ne 7.5 euro

Tarifa 7.5					
Shërbimet publike komunale	Nr klienteve	Faturimi mujor	Inkasimi mujor 95%	Faturimi vjetor	Inkasimi vjetor 95 %
Amviseria rezident	8958	67,185.00 €	63,825.75 €	806,220.00 €	725,598.00 €
Amviseri jorezident	5419	16,257.00 €	15,444.15 €	195,084.00 €	175,575.60 €
Institucione/biznese	1136	13,217.42 €	10,573.93 €	158,609.00 €	126,887.20 €
Total	14377		89,843.83 €		1,028,060.80 €

Me rritje tarifash 7.5 euro	1 dhe 12 muaj	12,959.21 €	155,510.47 €
-----------------------------	---------------	--------------------	---------------------

Tab.7. Planifikimi me rritje tarifes ne 7.5 euro

Planifikimi me rritje tarifash ne 7.5 euro ne do te kemi nje gjendje financiare prej 12,959.21 euro te hyra me shume se shpenzimet. Ketu duhet te kemi parasysh se ne vitin 2027 tarifa e mbeturinave ne KMDK do te kete ngritje per 1 euro ne ton dhe nuk eshte e perfshire te tarifa 7.5 euro

Nëse kjo rritje aprovohet atëherë kemi mundësi që edhe puntorëve të kemi një rritje të pagave nga 50 deri në 70 euro.

Ritja e Tarifës 6 euro është e pa përballueshme për Njësën Suharekë.

Planifikimi me rritje tarifes ne 6 euro

Tarifa 6					
Shërbimet publike komunale	Nr klienteve	Faturimi mujor	Inkasimi mujor 93 %	Faturimi vjetor	Inkasimi vjetor 93%
Amviseria rezident	8958	53,748.00 €	49,985.64 €	644,976.00 €	580,478.40 €
Amviseri jorezident	5419	16,257.00 €	15,119.01 €	195,084.00 €	175,575.60 €
Institucionet/bizneset	1136	13,217.42 €	10,573.93 €	158,609.00 €	126,887.20 €
Total	14377		75,678.58 €		882,941.20 €

Me rritje tarifes 6 euro	1 dhe 12 muaj	-1,206.04 €	-14,472.53 €
--------------------------	---------------	--------------------	---------------------

Tab. 8. Planifikimi me rritje tarifes ne 6 euro

Planifikimi me rritje tarifash ne 6 euro ne do te kemi nje gjendje financiare prej -1,206.04 euro te shpenzime me shume se te hyrat.

Kalkulimi i kostos për njesinë Suhareke

	Lloji I shpenzimeve	Vlera
1	Pagat	447,745.80 €
4	Nafta	106,869.53 €
5	Autogoma	10,875.18 €
6	Veshmbathje	9,092.37 €
7	Mirembajtje	86,195.67 €
8	Energji dhe uje	10,375.86 €
9	Regjistrimi I automjeteve	7,757.40 €
10	KMDK (Deponia)	163,201.96 €
11	Shpenzimet tjera	34,301.76 €
12	Marrveshja e ATK-se	46,200.00 €
	Totali I shpenzimeve	922,615.53 €
	Numri I klienteve	12653
	Kosto e sherbimit per amviseri me tvsh	6.08 €

Kalkulimi I Amvisërisë bëhet me 1/3 e jo rezidenteve dhe prandaj del numri i klienteve 12653.